



## **SYLLABUS I LËNDËS: “LETËRSI ARBËRESHE”**

| <b>Të dhëna bazike të lëndës:</b> |   |
|-----------------------------------|---|
| <b>Universiteti:</b>              | Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren  |
| <b>Njësia akademike:</b>          | Fakulteti i Filologjisë   |
| <b>Titulli i lëndës:</b>          | <b>Letërsi arbëreshe</b>  |
| <b>Programi:</b>                  | Gjuhë dhe letërsi shqipe  |
| <b>Niveli:</b>                    | Baçellor  |
| <b>Statusi lëndës:</b>            | Zgjedhore (Z)   |
| <b>Viti i studimeve:</b>          | Viti II, Semestri IV  |
| <b>Numri i orëve në javë:</b>     | 2 +1  |
| <b>Vlera në kredi – ECTS:</b>     | 3   |
| <b>Koha / lokacioni:</b>          | Semestri veror  |
| <b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>     | <b>Prof. ass. dr. Manjola Brahaj Halili</b>   |
| <b>Të dhënat kontaktuese:</b>     | <a href="mailto:manjola.brahaj@uni-prizren.com">manjola.brahaj@uni-prizren.com</a>  |
| <b>Përshkrimi i lëndës:</b>       | <p>Programi i kësaj lënde ofron njohuri për letërsinë arbëreshe, nga autorët e vjetër deri tek autorët e shek. XIX. Duke qenë se kolonitë arbëreshe të Italisë kanë mundur, jo vetëm të ruajnë traditën dhe kulturën e tyre, por edhe të krijojnë dhe zhvillojnë një letërsi të veçantë dhe me rëndësi për panoramën e përgjithshme të letërsisë shqipe. Ky kurs ofron njohuri dhe informacione rreth veprave dhe autorëve më të spikatur që kanë dhënë kontribut të shquar në ruajtjen dhe mbledhjen e folklorit, zhvillimin dhe përparimin e rëndësishëm të romantizmit, studimin dhe lëvrimin e gjuhës, kulturës, kritikës dhe të eseistikës shqiptare.</p>  |
| <b>Qëllimi i lëndës:</b>          | <p>Qëllimi këtij kursi është që të formësojë njohuritë e studentëve rreth kësaj letërsie dhe të realizojë aftësitë e tyre për progresin sistematik të letërsisë arbëreshe nga fillesat e në vazhdimësi. Ky kurs ka për qëllim që të pajisë studentët me informacion për poetikën dhe strukturën e zhvillimit të formacionit stilistik të letërsisë arbëreshe, si një ndër letërsitë e veçanta që diti ta mbajë të lidhur zhvillimin e saj me zhvillimet kryesore historike, shoqërore e kulturore të atdheut. Po ashtu ka për objektiva që të hartojë me kreativitet vështrimet dhe trajtesa individuale që kanë të bëjnë me vepra të veçanta dhe fenomene të përgjithshme të letërsisë arbëreshe, me lidhjen dhe ndikimet nga letërsia italiane, si dhe me lidhjen dhe frymëzimin që ka patur nga folklori, kultura dhe letërsia shqipe.</p> |
| <b>Rezultatet e të nxënit:</b>    | <p>Gjatë dhe pas përfundimit të këtij kursi, studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• njohin letërsinë arbëreshe prej veprave të para të autorëve kryesorë arbëresh;</li><li>• listojnë emra autorësh dhe veprash të rëndësishme të letërsisë arbëreshe;</li><li>• shpjegojnë vlerat, rolin dhe rëndësinë e letërsisë</li></ul>   |

|  |   |                  |                        |
|--|---|------------------|------------------------|
|  | <p>arbëreshe në raport me zhvillimin dhe letërsinë e përgjithshme shqipe;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• krahasojnë letërsinë evropiane (konkretisht italiane) me atë letërsisë shqiptare, duke u nisur nga rrethanat politike, ekonomike të cilat ndikuan tek idetë, temat, ligjërimet, figurat, stilet etj;</li> <li>• shkruajnë duke vlerësuar në mënyrë të pavarur, për autorë dhe vepra konkrete të kësaj letërsie.</li> </ul>   |                  |                        |
| <b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b> |   |                  |                        |
| <b>Aktiviteti</b>  | <b>Orë</b>  | <b>Ditë/javë</b> | <b>Gjithsej</b>        |
| Ligjërata  | 2   | 15               | 30                     |
| Ushtrime teorike/laboratorike  | 1   | 15               | 15                     |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet   | 1   | 10               | 10                     |
| Ushtrime në terren   | -   | -                | -                      |
| Kollokfiume, seminare  | 2   | 2                | 4                      |
| Detyra të shtëpisë   | 2   | 3                | 6                      |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)                         | 1   | 5                | 5                      |
| Përgatitja përfundimtare për provim  | 1   | 1                | 1                      |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)  | 2   | 2                | 4                      |
| <b>Totali</b>  |   |                  | <b>75 orë (3 ECTS)</b> |
| <b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>  | <p>Ligjëratat do të organizohen në modelin ndërvepruese apo të kombinuar si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtime idesh, hartime krijuese e vetëhulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe aplikimin e metodologjisë së ligjëruarit.</p>   |                  |                        |
| <b>Metodologjia e vlerësimit:</b>  | <p>Vlerësimi i studentëve bazohet në punën, aktivizimin, frekuentimin, kolekviumet dhe punimin e prezantuar në përmbyllje të semestrit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Testi i parë: 1 – 30 %,</li> <li>2. Testi i dytë: 1 – 30 %,</li> <li>3. Prezantimet studentore 1 – 20 %,</li> <li>4. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 1 – 20 %,</li> <li>5. Totali: 100 pikë</li> </ol> <p>Vlerësimi në pikë:<br/>01-50= 5, 51-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10</p> |                  |                        |
| <b>Literatura</b>  |   |                  |                        |
| <b>Literatura primare:</b>   | <p>Rexhep Qosja: Histori e letërsisë shqipe- Romantizmi I, II, III, IAP, Prishtinë, 2010.</p>   |                  |                        |

|                           |  |
|---------------------------|--|
|                           | <p>Klara Kodra: Tipologjia e poemës arbëreshe, ASHSH, Tiranë, 2000.</p> <p>Ali Xhiku: Romantizmi arbëresh, Tiranë, 1980, Prishtinë, 1982.</p> <p>Matteo Mandala: Gjurmime filologjike, Çabej, Tiranë, 2006.</p> <p>Robert Elsie: Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 1997.</p>  |
| <b>Literatura shtesë:</b> | <p>Antologji e letërsisë së Arbëreshëve të Kalabrisë. Grup autorësh. Universitá della Calabria, Cozenza, 2009.</p> <p>Eqrem Çabej: Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, MÇM, Tiranë, 1994.</p> <p>Francesko Altimari: Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe. Shpresa &amp; Fail Konica, Prishtinë, 2002.</p> <p>Klara Kodra: Poezia e De Radës, Rilindja, Prishtinë, 1990.</p> <p>Sali Bashota: Studime letrare, Toena, Tiranë, 2008.</p> <p>Grup autorësh: Histori e letërsisë shqipe I-II, Rilindja, Prishtinë, 1975.</p> |

| <b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b> |   |   |
|-------------------------------------|---|---|
| <b>Java</b>                         | <b>Ligjërata</b>  | <b>Ushtrime</b>   |
| <i>Java e parë:</i>                 | <b><i>Hyrje në letërsinë arbëreshe</i></b><br>(Përshkrim hyrës në kontekstin historiko – letrar arbresh)            | <i>Diskutime rreth origjinës, zhvillimit dhe kontekstit në të cilin u krijua letërsia arbëreshe</i>                     |
| <i>Java e dytë:</i>                 | <b><i>Kolonia e arbëreshëve të Italisë</i></b><br>(Rrethat historike. Jeta kulturore e shqiptarëve përtej detit)    | <i>Biseda dhe diskutime rreth kushteve nëpër të cilat kaluan arbëreshët dhe kultura e tyre</i>                          |
| <i>Java e tretë:</i>                | <b><i>Letërsia arbëreshe në shekullin XVIII</i></b><br>(Shekulli i XVIII. Veprat e para të letërsisë arbëreshe)     | <i>Rëndësia e veprave të para. Biseda dhe punë në grupe</i>   |
| <i>Java e katërt:</i>               | <b><i>Përparimi intelektual e kulturor i arbëreshëve të Sicilisë dhe Kolegji grek i Palermos</i></b>                | <i>Diskutime për përparimin intelektual arbëresh dhe rolin e Kolegjit grek të Paleros</i>                               |
| <i>Java e pestë:</i>                | <b><i>Lekë Matrënga</i></b><br>Koha dhe vepra e tij<br>Vepra “E mbsuame e Kërshterë”- analizë                       | <i>Pyetje, diskutime dhe komente rreth aspekteve letrare dhe fetare të veprës “E mbsuame Kërshterë” të L. Matrëngës</i> |
| <i>Java e gjashtë:</i>              | <b><i>Vepra e pabotuar e at Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII</i></b>                      | <i>Shkrime, vlerësime dhe gjykime për rolin e figurës së Gj. Guxetës në zhvillimin e arsimit dhe albanologjisë</i>      |
| <i>Java e shtatë:</i>               | <b><i>Mbi veprat dhe rëndësinë e krijimtarisë së Pal Maria Parrinos, Nikollë Brankati dhe të Nikollë Filjës</i></b> | <i>Diskutime dhe komente rreth rëndësisë së veprave të Parrinos, Brankatit dhe Filjës</i>                               |
| <i>Java e tetë:</i>                 | <b><i>Testi i parë vlerësues</i></b>  | <i>Përmbledhje e lëndës</i>   |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <i>Java e nëntë:</i>   | <b><i>Nikollë Keta, Jul Variboba dhe autorë të tjerë të shekullit XVIII</i></b><br>(Jeta dhe veprat dhe botimet e Zef Barçës, Gjon Thoma Barbaçit, Gavril Dara dhe Plakut)          | <i>Diskutime dhe komente rreth shek XVIII dhe rolit të tij në ngritjen e kulturës arbëreshe</i>          |
| <i>Java e dhjetë:</i>  | <b><i>Letërsi arbëreshe e shekullit XIX</i></b><br>(Frymëzim dhe pararendëse për letërsinë romantike shqiptare. Puna e madhe në mbledhjen e folklorit)                              | <i>Diskutime rreth rëndësisë dhe vlerës së folklorit të mbledhur nga arbëreshët e shek XIX</i>           |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i>  | <b><i>Përfaqësuesit kryesorë të letërsisë romantike arbëreshe- De Rada</i></b><br>(Analizë e veprave; “Rapsodi e në poemë arbëreshe” dhe “Serafina Topia”)                          | <i>Lexime të fragmenteve të veprës “Serafina Topia” dhe diskutime rreth, realizimit, gjuhës, stilit.</i> |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i>   | <b><i>Përfaqësues tjerë të letërsisë romantike arbëreshe</i></b> (Anton Santori, Gavril Dara i Riu, Zef Serembe, Vinçens Stratigoi dhe Leonardo de Martino)                         | <i>Lexime të poezive të Z. Serembes. Komente dhe diskutime rreth dramës “Emira” të F. A. Santorit</i>    |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i>  | <b><i>Lëvizja kulturore letrare e arbëreshëve të Greqisë në shekullin XIX</i></b><br>(Figurat më të shquara të lëvizjes patriotike dhe kulturore letrare të arbëreshëve të Greqisë) | <i>Diskutime për kontributin e Anastas Kulluriotit dhe Panajot Kupitorit</i>                             |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i>   | <b><i>Figura e Skenderbeut në rapsoditë e De Radës dhe në letërsinë gojore arbëreshe. Eqerem Çabeji për letërsinë arbëreshe</i></b>   | <i>Lexime dhe diskutime rreth këngëve e legendave për Skënderbeun</i>                                    |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>   | <b><i>Testi i dytë vlerësues</i></b>  | <i>Konsultime dhe diskutime rreth rezultateve</i>  |
| <b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>   |   |  |
| <p>Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studentët duhet t’u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor.</li> <li>• Pritet që secili student të vijë me kohë.</li> <li>• Nga çdo student pritët që të marrë pjesë në çdo ligjeratë.</li> <li>• Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë.</li> </ul> |   |  |